



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVA - REPUBLIC OF KOSOVO
KËSHILLI GJYQËSOR I KOSOVËS - SUDSKI SAVET KOSOVA - KOSOVO JUDICIAL COUNCIL
PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA
IZBORNI PANEL ZA ŽALBE I PREDSTAVKE - ELECTION COMPLAINTS AND APPEALS PANEL

ZL.Anr.330/2025

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA (PZAP), në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Bujar Muzaqi – kryesues, Violeta Husaj Rugova dhe Bujar Muzaqi - anëtarë, duke vendosur përkitazi me ankesën e Kreshnik Sopi, kandidat për asamble komunale në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lista për Prishtinën, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën Komunale Numërimit (QKN), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025, në seancën e panelit të mbajtur më datë 25.10.2025, merr këtë :

V E N D I M

HEDHET E PASAFATSHME ankesa ZL.Anr.330/2025 datë 25.10.2025, e parashtruar nga Kreshnik Sopi, kandidat për asamble komunale në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lista për Prishtinën, të parashtruar kundër Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), për shkak të parregullsive në Qendrën Komunale Numërimit (QKN), në Zgjedhjet Lokale, të mbajtura më datë 12 Tetor 2025.

A r s y e t i m

PZAP-i më datë 23.10.2025, ka pranuar ankesën ZL.Anr.330/2025, nga Kreshnik Sopi, kandidat për anëtarë të kuvendit komunal në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lista për Prishtinën, për shkak të parregullsive në Qendrën e Numërimit të Rezultateve (QNR), me të cilën pretendohet sa ka pasur parregullsi në shkollën Nena Tereza-Vranidoll, në klasën 1947/01 dhe 1907/02, ashtu që ka pasur disbalanc të madh mes Listës për Asamble komunale, dhe asaj për kryetar komune, sepse kandidati i cili supozohet që ka marrë 90% të votave si kandidat për asamble nuk është në përputhje me përqindjen e kandidatëve për kryetar komune. Kanë kërkuar nga PZAP, hapjen e kutive të votimit në vendvotimet e lartpërmendura të Komunës së Prishtinës, urdhëroj numërimin e plot të votave në prani të përfaqësuesve të subjekteve politike dhe të monitoruesve të akredituar, pezulloj publikimin e rezultateve përfundimtare për këto vendvotime deri në përfundimin e rinumërimit.

Në përgjigje në ankesë të paraqitur me datë 24.10.2025, nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ), kanë deklaruar se bazuar në nenin 101 të LZP-së Nr.08/L-228, Rregulloren Zgjedhore Nr.16/2024, Qendrat Komunale të Numërimit (QKN), Procedura e veprimit në Qendrën Komunale të numërimit për Zgjedhjet Lokale 2025, e miratuar me 01.10.2025, Nr.01/2601/2025, përcaktohet procedurat e detajuara lidhur me procesin e numërimit në QKN.

Andaj bazuar në Rregulloren Zgjedhore Nr.13/2024 Rezultatet Zgjedhore në nenin 9 paragrafi 1 thekson se në rastet të mospërputhjes së rezultateve, QKZ-ja mund të urdhërojë rinumërimin e votave të cili do VV, ose edhe përsëritjen e votimit në një VV apo QV. Në lidhje me pretendimet e palës ankuese për rinumërimin të votave në vendvotime nr.1947/01 dhe 1907/02, kanë deklaruar se anesa është paraqitur jashtë afatit ligjor për paraqitje e ankesës, pasi sipas konfirmimit të ZEKKZ-së në komunën e Prishtinës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datë 18.10.2025 në orën 23:50, ndërsa pala e ka parashtruar ankesën e ka parashtruar me datë 23.10.2025, pra nuk është brenda afatit ligjor ashtu siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.

Tutje, kanë theksuar se rezultatet përfundimtare të procesit zgjedhor, shpallen nga KQZ-ja pas përfundimit të numërimit të gjitha fletëvotimeve nga vendvotimet e rregullta; fletëvotimeve nga votimit me kusht; fletëvotimet nga votimi i personave me nevoja të veçanta; fletëvotimeve nga votimi jashtë Kosovës; vendosjes për ankesat eventuale nga PZP dhe Gjykata Supreme dhe pas përfundimit të të gjitha procedurave në QNR, ku rezultati i publikuar është i ankimueshëm nga subjekte politike dhe kandidatët të cilët kanë pretendime në raport me numërimin e votave të tyre. Pra, në momentin e publikimit të rezultateve përfundimtare nga KQZ-ja, palët e pakënaqura në pajtim me nenin 105 të LPZ, pala mund të ushtrojë ankesë në afatin brenda dyzet e tetë (48) orëve në PZAP. Në kuptim të nenit 117 paragrafi 3 të LJP, gjatë shqyrtimit të ankesës është vërejtur se pala ankuese nuk ka bashkëngjitur prova të mjaftueshme që do të mund të dëshmonin apo mbështesin pretendimet e saj të paraqitura në ankesë.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës - PZAP, pas shqyrtimit të ankesës dhe shkresave të lëndës, gjeti se:

-Ankesa është e pasafatshme.

Në këtë rast, nga shqyrtimi i shkresave të lëndës, konstatohet se ankesa e parashtruar nga Kreshnik Sopi kandidat për asamble komunale në Komunën e Prishtinës, nga radhët e subjektit politik Lista për Prishtinën e parashtruar kundër KQZ, ku ka pretenduar se ka pasur parregullsi në Qendrën Komunale të Numërimit (QKN) lidhur me manipulim të votave është parashtruar pas afatit të përcaktuar ligjor.

Me dispozitën e nenit 105 paragrafi 1, në mënyrë decisive parashihet se *"Ankesat lidhur me administrimin e numërimit në QKN dhe QNR, dorëzohen me shkrim pranë PZAP-së brenda dyzet e tetë (48) orëve nga ndodhja e shkeljes së supozuar," të Ligjit Nr. 08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës.*

Me dispozitën e nenit 9 paragrafi 5 të Rregullores Nr. 01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet që *"Personi mund të paraqes ankesë në PZAP, brenda dyzet e tetë (48) orëve për shkeljet e pretenduara"*, ndërsa nën paragrafi 5.16. parashihet që *"Për shkeljet e pretenduara gjatë procesit të administrimit dhe numërimit në QKN dhe QNR"*.

Neni 13, para. 3, nën para. 3.2 i Rregullores Nr.01/2025 për Procedurat e Parashtrimit dhe Vendosjes së Ankesave të PZAP-it, në mënyrë decisive thuhet që: *"PZAP-i e hedhë ankesën kur vlerëson se ajo nuk është dorëzuar në afatin e paraparë ligjor."*

Në rastin konkret Paneli vlerëson se parashtruesi i ankesës ka dorëzuar ankesën në PZAP me datë 23.10.2025, ndërsa nga të dhënat zyrtare, e po ashtu edhe nga përgjigja e KQZ është vërtetuar me konfirmimin e ZEKKZ në Komunën e Prishtinës, aktiviteti i QKN-së është përmbyllur me datën 18.10.2025, në orën 23:50, me çka vërtetohet se ankesa e ankuesit nuk është paraqitur brenda afatit ligjor prej 48 orëve, siç parashihet me nenin 105, paragrafi 1 të Ligjit për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, andaj dhe ankesa u deshtë që të hedhet si e pasafatshme.

Nga arsyet e theksuara më lartë dhe duke u bazuar nenin 105 paragraf 1 i LZP-së, nenit 117 paragrafi 3, dhe nenit 118 paragrafi 1 të Ligjit Nr.08/L-228 Për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës lidhur me nenin 9 paragrafi 5 nën paragrafi 5.16, nenin 13, paragrafi 2, neni 13 paragrafi 3 nën paragrafi 3.2 të Rregullës 01/2025 për Procedurat e Parashtrimin dhe Vendosjes së Ankesave, paneli vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PANELI ZGJEDHOR PËR ANKESA DHE PARASHTRESA

ZL.Anr.330/2025 më datën 25.10.2025

**Kryesues i Panelit,
Bujar Muzaqi**



KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 paragrafi 4 të Ligjit Nr.08/L-228 për Zgjedhjet e Përgjithshme në Republikën e Kosovës, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda dyzet e tetë (48) orëve nga momenti i marrjes-pranimin të këtij vendimi.